

VENDIM
Nr. 64, datë 24.11.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “MBI TRANSPARENCËN
PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 53, pika 4, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 55, të nenit 56, pika 2, të neneve 69, 124 dhe 125, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 29.8.2008, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 4, pika 2, pas shkronjës “d”, shtohen shkronjat “e” dhe “f”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“e) indeksi orientues” - përfaqëson normat ndërbankare të ofruara të interesit, të cilat publikohen nga autoritetet rregullatore apo autoritetet e autorizuar për administrimin e tyre dhe/ose norma të tjera interesi që kuotohen në treg në mënyrë të vazhdueshme dhe janë transparente për publikun e gjerë e që njehsohen me normat e interesit të instrumenteve të borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore të vendeve të ndryshme. Këto norma përfaqësojnë normat referencë që përdoren gjerësisht në çmimin e transaksioneve financiare;”;

“f) klauzolë e ndryshimit të indeksit orientues” - është parashikimi kontraktor i përcaktuar në kontratën e kredisë, e cila i jep të drejtë bankës të zëvendësojë indeksin orientues, në rastet e aplikimit të interesit të përbërë, nëse ndodh një ndërprerje e kuotimit të këtij indeksi orientues për monedhën e kredisë. Kjo klauzolë aplikohet vetëm me kusht që, nga autoritetet rregullatore apo autoritetet e autorizuar për administrimin e indeksit, të ketë një përcaktim të qartë të datës së ndërprerjes së kuotimit të indeksit orientues për monedhën dhe zëvendësimin e tij me një indeks orientues alternativ të publikuar nga këto autoritete.

Banka e Shqipërisë publikon në faqen e saj zyrtare të internetit, në çdo rast, burimin e informacionit (faqen zyrtare të internetit) të autoritetit rregullator apo të autoritetit të autorizuar për administrimin e indeksit, që publikon indeksin orientues alternativ përkatës.”;

b) në nenin 5, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

i. pika 9, ndryshon si më poshtë: *“Bankat nuk ndryshojnë, pa pëlqimin e klientit, gjatë kohëzgjatjes së kontratës/marrëveshjes së kredisë metodën/metodologjinë e llogaritjes së normës së interesit dhe/ose elementet përbërëse të saj, penalitetet në rast vonese/kamatëvonesat, si dhe çdo parashikim tjetër që e ngarkon klientin me kosto financiare, për të cilën/at është rënë dakord me klientët në momentin e lidhjes së marrëveshjes/kontratës së kredisë.”;*

c) në nenin 7, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1, shkronja “c”, hiqet togfjalëshi *“(norma e marrëveshjes së riblerjes e Bankës së Shqipërisë, norma e bonove të thesarit, libor, euribor, tribor)”;*

ii. në pikën 1, pas shkronjës “g”, shtohet shkronja “h” me përmbajtjen e mëposhtme:

“h) klauzolën e ndryshimit të indeksit orientues;”;

d) në nenin 14, ndryshohet titulli, i cili bëhet *“Të fundit”* dhe shtohet pika 3 sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“3. Klauzola e ndryshimit të indeksit orientues nuk zbatohet për marrëveshjet e kredive të miratuara, përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, me përjashtim të rasteve kur banka merr

masat e nevojshme për përfshirjen, me miratimin e kredimarrësit, të klausolës së ndryshimit të indeksit orientues në marrëveshjet e kredive të lidhura para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko